

ANALIZA GJEO-HAPËSINORE OPORTUNITET PËR ZHVILLIMIN E NJË PLANI STRATEGJIK

*HYSENAJ M.¹, HOXHA E.²

¹Universiteti i Shkodrës, Fakulteti i Shkencave Shoqërore, Departamenti i Gjeografisë

²Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë, Departamenti Statistikë dhe Informatikë e Zbatuar

email: mhysenaj@unishk.edu.al

Përmbledhje

Qëllimi i këtij punimi konsiston në prezantimin e mjeteve gjeo-hapësinore të shfrytëzuara kryesisht përmes shërbimit web-mapping si një oportunitet në analizën dhe menaxhimin përkundrejt çështjeve dhe problematikave të aspektit ekonomik. Kjo nismë ushqehet nga projeksionet gjithnjë e në rritje të rolit që luajnë teknikat gjeo-informatike në një gamë të gjerë profilesh si çelës në vendimmarrje. Implementimi i tyre vjen natyrshëm, pasi është e vështirë që një entitet apo objekt i çfarëdolloj natyre të mos jetë i lidhur me referenca gjeo-hapësinore. Shpërndarja, drejtimi, distancat, relacionet, pozicioni, etj janë vetëm disa nga fenomenet që i bashkangjiten analizave të mirëfillta ekonomike dhe që përfaqësohen nga nocionet si koordinatat dhe shtrirja. Shembujt e paraqitur në këtë punim shërbejnë si një shtysë e mëtejshme në përfaqimin e teknikave gjeo-informatike që tashmë po përhapen gjithnjë e më tepër në vendin tonë.

Abstract

The paper goal is to present geo-tools primarily exploited through web-mapping services as an opportunity to analyse and manage issues and problematics of economic aspect. This initiative fueled by projections of the increasing role geo-informatics techniques are playing in a wide range of profiles as key decision making. Their implementation comes naturally due to the fact that most of the real objects are strictly connected to spatial references. Dispersion, direction, relations, position, etc are only a few of the phenomena related to genuine economic analyses also represented by notions such as geographic coordinates and extension. The performed analysis serve as a further incentive to embrace geo-informatic techniques that are already spreading more and more in our country.

Fjalëkyçe: gjeo-informatikë, analizë, hapësirë gjeografike, ueb.

Hyrje

Tashmë me përhapjen në treg gjithnjë e më të madhe që po zënë mjetet portabël si laptop, tablet, smartfone, etj të cilat karakterizohen nga parametra gjithnjë e në rritje të përpunimit të të dhënave, shfrytëzimi i informacioneve gjeografike bëhet gjithnjë e më prezent. Aksesit i palimituar në ueb si dhe familjarizimi me përfaqjen ndaj aplikacioneve multimediale, krijon mundësi të mëdha në shfrytëzimin e aplikacioneve ueb-gis.

Bizneset po zgjerohen gjithnjë e më tepër duke krijuar rrjet njësisish periferike të shpërndara në mbarë vendin. Sistemet gjeografike shërbejnë si suport ideal për të lidhur këto nyje me njëra-tjetrën duke ruajtur koherencën dhe konsistencën e shkëmbimit të të dhënave. Biznesi inteligjent (BI) i referohet teknologjive dhe mjeteve që shfrytëzohen me qëllim mbledhje, menaxhim dhe analizim të të dhënave që lidhen me aktivitetin e biznesit dhe GIS bën pjesë në këtë kategori (Karen, 2007).

Nga ana tjetër ndarja e re territoriale në vend kërkon një ristrukturim të analizave të deritanishme pasi çdo entitet ka një lidhje me referencat hapësinore. Bizneset duhet të riorganizojnë dhe ripërcaktojnë strategji të reja në përshtatje me ndryshimet e fundit administrative. Aplikacionet GIS që operojnë në vend duhet të rifreskojnë të dhënat, pasi çdo informacion i ruajtur në nivel *rrethi* tashmë bëhet jo konsistent dhe duhet zëvendësuar me shtrirjen e re hapësinore në nivel *bashkie*. Kjo kërkon një ndërhyrje në databazat respektive dhe një ripërcaktim të gjithë të dhënave gjeografike sipas zonës së re.

Materiali dhe metodat

Në vazhden e trendit që karakterizon sistemet e informacionit gjeografik mund të themi që ato përmbushin më së miri mundësinë e integritimit në një platformë të vetme, paraqitjet numerike dhe hapësinore. Duke ditur që aspekti vizual është tejet i rëndësishëm në përmirësimin e vendimmarrjeve por që gjithashtu duhet mbështetur ngushtë mbi një bazë të dhënash numerike, krijohet një kombinim ideal që optimizon ndjeshëm sistemin.

GIS ofron paraqitje në hartë shoqëruar me mundësinë e gjenerimit të raporteve dhe strukturave përmbledhëse mjaft komplekse. Nga ana tjetër me një bazë të dhënash të plotë përdoruesi mund të shtrojë një gamë të gjerë pyetjesh (*query*) mbi çdo problematikë të krijuar. Në vijimësi mjetet gjeo-hapësinore mund të përdoren dhe si mundësi për të simuluar situata duke krijuar parashikime dhe ofruar rekomandime për vendimmarrje të së ardhmes (Sahoo, 2008).

Ne shfrytëzojmë hartat dixhitale pasi ato përbëjnë një pjesë thelbësore të GIS. Ato kanë ngritur në një nivel shumë më të lartë konceptin e hartës në tërësi duke i bashknagjitur asaj mundësitë e ushtrimit të proceseve analitike (Grant, 2000). Platforma gjeo-hapësinore mbështeten mbi internetin. Ato strukturohen me qëllim shpërndarjen e të dhënave gjeo-hapësinore, shërbimeve dhe aplikacioneve për të përmbushur nevojat informuese të popullatës.

Tashmë metodat tradicionale të kërkimit janë zëvendësuar me zhvillimin e kërkimit online përmes platformave të cilat ofrojnë njëkohësisht të dhëna të përditësuar të ruajtura në sisteme databaze të shoqëruara me ambient vizual në trajtën e hartave dixhitale përmes së cilave kontrollohet rezultati i arritur.




Figura 1. Kërkim i shtrirë (zgjeruar) - Paraqitje gjeo-hapësinore e strukturave akomoduese dhe shërbimeve në nivel qarku (*hotel, bar, restorant*)

Ky punim ofron një shembull mbi një rast studimi i cili ndahet në dy faza. Faza e parë mbështetet mbi një kërkim të përgjithshëm i cili gjeneron një output që do të shërbejë për një kërkim më specifik që do të pasojë. Marrim në konsideratë një investitor të huaj i cili zotëron një kapital dhe kërkon të investojë mbi një strukturë hoteliere. Duke mos njohur hapësirën gjeografike të territorit tonë mundësitë për gabime janë të larta në rast se nuk shoqërohen me një studim të detajuar të territorit.

Sistemet e Informacionit Gjeografik në tërësi dhe hartat dixhitale në veçanti si pjesë integrale dhe e rëndësishme e mjeteve gjeo-hapësinore janë zgjidhja ideale për realizimin e një studimi të mirëfilltë që do të identifikonte zonën më optimale. Kërkimi duhet të mbështetet mbi një proces filtrimi si fillim mbi një shtrirje të gjerë hapësinore (figura 1) ku zhvillohet një investigim i shpërndarjes së strukturave të ngjashme në territorin e vendit tonë. Duke marrë në konsideratë raportin numër pushuesish/njësi akomodimi investitori arrin në përfundim se plazhi i Velipojës paraqet një mundësi interesante investimi dhe që plotëson më së miri kushtet në raport me zona e tjera gjeografike.

Harta dixhitale mbështetet mbi një strukturë vektoriale (Burim i të dhënave referencë: GADM, Global Administrative Areas). Sistemi koordinativ i përdorur është GCS_WGS_1984 dhe të dhënat D_WGS_1984. Të dhënat për formulimin e hartës janë marrë nga Instituti i Statistikave ndërsa vetë harta paraqitet në nivel qarku me një shkallë zvogëlimi 1:2.250.000. Outputi i derivuar nga kjo analizë do të shërbejë si input për t'u thelluar akoma më shumë në zonën tashmë të identifikuar si më të përshtatshme ndaj kërkesave të përdoruesit. Zona në fjalë ka një shtrirje më të vogël gjeografike dhe filtrimi tashmë merr përmasa më të detajuar dhe specifike.

Një formë e tillë kërkimi përshpejton zhvillimin analitik të problematikës dhe lehtëson procesin e vendimmarrjes. Shembulli i dytë siç pasqyrohet në figurën 2 i referohet një procesi të mirëfilltë kërkimi ku investitori tashmë mbi të dhënat gjeo-hapësinore të grumbulluara nga kërkimi i parë ka arritur në një konkluzion në lidhje me hapësirën më të përshtatshme për të proceduar me investimin e tij dhe interesohet të ndërtojë një strukturë hoteliere në një zonë plazhi.

Qëllimi kryesor që paraprin investimin është një studim i mirëfilltë i zonës në lidhje me bizneset konkurente që operojnë në të njëjtën zonë dhe që zhvillojnë të njëjtën linjë biznesi ose të ngjashme me të (*hotele, bare, restorante*). Duke përcaktuar rrezet e kërkimit (5 kilometër) përdoruesi eliminon entitetet që nuk i përkasin kategorive në fjalë, gjithashtu që nuk përfshihen brenda rrezes së kërkimit.

Për të plotësuar akoma më shumë kuadrin e kërkimit përdoruesi mund të thellohet dhe në faktorë të tillë si distancat nga rrugët primare dhe dytësore, kushtet klimaterike, dendësia e popullsisë, niveli ekonomik i zonës, etj. Të gjitha këto kritere do të rrisnin ndjeshëm nivelin e faktorit të suksesit. Ndërfaqet e ofruara tanimë shmangin në pjesën më të madhe nevojën për të zotëruar njohuri të thelluara informatike pasi mjetet dhe bashkësitë e komandave që përbëjnë aplikacionin mbulojnë kërkimin e zhvilluar gjerësisht. Nga ana tjetër mbivendosja e simboleve gjeografikë mbi harta të parapërcaktuara që ofron tregu të tilla si *Google Map* eviton ngarkimin e hartës në tërësi duke ofruar performancë mjaft të lartë dhe shpejtësi të madhe në realizimin e veprimeve.




Figura 2. Kërkim specifik - Paraqitje gjeo-hapësinore e strukturave akomoduese dhe shërbime në nivel qarku (*hotel, bar, restorant*); Hapësira gjeografike - plazhi Velipojë

Përfundime

Të zotërosh informacionin e duhur do të thotë të kesh pushtet në zbatimin e vendimmarrjeve të duhura (Hysenaj, 2011). Ky është qëllimi kryesor i implementimit të mjeteve gjeo-hapësinore. Materiali i analizuar shtjellon një proces kërkimi që mbështetet mbi teknologjinë GIS që nga origjina e deri në detajet më të hollësishme. Kërkimi starton në nivel qarku mbi të cilën krijohet një ide e përgjithshme e shpërndarjes së entiteteve. Pastaj ndiqet nga një kërkim specifik më i organizuar i cili mbështetet mbi një hapësirë të kufizuar gjeografike. Raporti i gjeneruar së bashku me paraqitjen vizuale në background ndihmojnë në vendimmarrje të sakta.

Shumica e organizatave dhe institucioneve në mbarë Europën kanë kuptuar që të dhënat hapësinore zënë përqindjen më të madhe të sistemeve të databazave që ato kanë të integruar (Moore, 2002). Gjeodatabazat po zëvendësojnë databazat tradicionale dhe kjo vjen kryesisht pasi pjesa më e madhe e të dhënave që qarkullojnë kanë referenca hapësinore. Punimi vë në dukje teknologjitë gjeo-hapësinore si formë bashkëkohore e përpunimit dhe analizimit të informacioneve dhe të dhënave të cilat kanë në përmbajtje të tyre referenca hapësinore.

Literatura

Jaroslav B. (2008): GIS Analytical Tools for Planning and Management of Urban Processes

Openshaw S., Alvanides S (2005): Applying geocomputation to the analysis of spatial distributions

Karen A. (2007): Using GIS Technology for Document and Asset Management

Sahoo R. K. (2008): Gis Tools in Business Analysis

Grant M. (2000): Understanding GIS, <http://www.innovativegis.com>

Building the business case for the geospatial platform the value proposition (2011): FGDC (Federal Geographic Data Committee)

Hysenaj M. (2011): Geographical Information Systems, Shkoder, Albania Instituti i Statistikave në Shqipëri, INSTAT

Moore D. R., Hogan C. (2002): GIS in a Knowledge Domain: Bringing GIS to operational integration in Spatial Planning